

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KORÇË
PËR VITIN 2025

Nr. Rendor¹	Data e kërkesës²	Objekti i kërkesës³	Data e përgjigjes⁴	Përgjigje⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës⁶	Tarifa⁷
1.	20.01.2025	Kërkesë për informacion nga organizata SCiDEV në të cilën kërkohet, 1. Statistika për numrin e çështjeve civile me palë gazetarë punonjës të medias për periudhën 1 Janar 2024 31 Dhjetor 2024, të ndara sipas neneve 617 "Publikimet mashtruese ose të pasakta", 625 "Përgjegjësia për dëmin jopasuror", 647/a të Kodit Civil. 2. Statistika për numrin e çështjeve penale me palë gazetarë/punonjës të medias për periudhën	31.01.2025	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë pasi u njoh me shkresën me nr. 123/1 prot datë 15.01.2025, të Këshillit të Lartë Gjyqësor protokolluar pranë gjykatës me nr. 203 prot, datë 20.01.2025, në të cilën kërkohet informacion mbi numrin e çështjeve civile dhe penale me pale gazetarë/punonjës të medias për periudhën 1 Janar 2024 deri në 31 Dhjetor 2024, ju bëjme me dije se:	E plotë	Nuk ka

¹Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

²Data e regjistrimit të kërkesës

³Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴Data e kthimit të përgjigjes

⁵Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/E refuzuar/E deleguar

⁷Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

		1 Janar 2024-31 Dhjetor 2024, të ndara sipas neneve 119 "Fyerja", 120 "Shpifja", 121 "Ndërhyrje të padrejta në jetën private", 143/b "Mashtrimi kompjuterik", 186/a "Falsifikim kompjuterik", të Kodit Penal. Ti dërgove 3. Si kanë ndryshuar statistikat e vitit 2024 në raport me vitin 2023 lidhur me këto çështje? 4. Vendimmarrja përkatëse për këto çështje: vendime dënimi, pafajësie, pushimi, pranim apo rrëzim padie. 5. Informacion mbi numrin e çështjeve të reja për vitin 2024 dhe informacion për sa çështje janë të mbartura. 6. Informacion mbi faktin nëse disponohet një regjistër të dhënash mbi gazetarët dhe punonjësit e mediave ku regjistrohen rastet e padive/çështjeve ndaj		Nga verifikimi i sistemit ICMIS për periudhën Janar Dhjetor 2024, nuk rezulton e depozituar për gjykim asnjë çështje gjyqësore me palë gazetarë apo punonjës të medias. Përsa i përket kërimit Tuaj, për statistikat lidhur me këtë kategori për vitin 2023, nuk rezulton asnjë kërkesë e depozituar për gjykim e çështjeve civile apo penale me palë gazetar apo punonjës të medias. Përgjatë vitit 2024, janë regjistruar për gjykim 3288 çështje të reja civile dhe penale dhe janë mbartur nga vitet e kaluara 2166 çështje gjyqësore. Sqarojmë se, pranë gjykatës nuk ka një database ku të jenë të pasqyruara të dhënat mbi gazetarët apo punonjësit e medias, por administrohet një regjistër ku regjistrohen kërkesëpaditë dhe	
--	--	---	--	--	--

		tyre.		kërkesat e ndryshme që vinë në gjykatë.		
2.	24.01.2025	Kërkesë për informacion vënie në dispozicion të vendimit penal ndaj shtetasit G.Gj nga gazetari E.M	30.01.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, bashkëngjitur po ju vendosim në dispozicion vendimin e anonimizuar ndaj shtetasit G.Gj.	E plotë	Nuk ka
3.	27.01.2025	Kërkesë për informacion në të cilën kërkohet, 1-Sa shtetas janë dënuar me "punë me interes publik" nga viti 2020-31.12.2024; (të dhënat e ndara sipas gjykatave në Republikën e Shqipërisë) 2-Sa zyrtarë janë dënuar me "punë me interes publik" nga gjykatat e posaçme të shkallës dhe apelit për korrupsionin dhe krimin e organizuar, nga viti 2020-31.12.2024. 3-Për çfarë veprash penale janë dënuar shtetasit shqiptarë (pika 1) dhe zyrtarët (pika 2)? Nga gazetaria A.H	04.02.2025	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë pasi u njoh me shkresën me nr. 256/1 prot datë 23.01.2025, përcjellë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor mbi bazën e kërkesës tuaj, protokolluar pranë gjykatës me nr. 322 prot, datë 27.01.2025, lidhur me informacionin se sa shtetas janë dënuar me “punë me interes publik” nga viti 2020-31.12.2024 dhe për veprat përkatëse, ju informojmë si më poshtë: - Nga verifikimi i kryer në kryesekretari për periudhën 2020-31.12.2024 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë	E plotë	Nuk ka

				janë dënuar 111 shtetas ku është aplikuar neni 63 i Kodit Penal. - Veprat penale për të cilët janë dënuar këta shtetas janë si më poshtë: Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt - 65 të dënuar. Falsifikimi i dokumentave - 7 të dënuar. Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik - 5 të dënuar. Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor - 3 të dënuar. Ndërtimi i paligjshëm - 3 të dënuar. Vjedhja - 3 të dënuar. Largimi nga vendi i aksidentit - 3 të dënuar. Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shperthyese dhe i municionit - 3 të dënuar. Dhuna në familje - 3 të dënuar. Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje e armëve të ftohta - 3 të		
--	--	--	--	---	--	--

				dënuar. Organizimi i llotarive të palejuara - 2 të dënuar. Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik - 2 të dënuar. Falsifikimi i vulave, i stampave ose i formularëve - 2 të dënuar. Kontrabanda me mallra të tjera - 1 i dënuar. Kallëzimi i rremë - 1 i dënuar. Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë - 1 i dënuar. Fshehja e të ardhurave - 1 i dënuar. Neglizhenca në trajtimin mjekësor - 1 i dënuar. Ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve - 1 i dënuar. Kanosja - 1 i dënuar.		
4.	10.02.2025	Kërkesë për informacion referuar ligjit Nr. 119/2014 për të Drejtën e Informimit, konkretisht neneve 11, 12, 14 dhe 15 të tij kërkojmë nga ju	10.02.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj elektronike datë 10.02.2025 ju informojmë se: Referuar procesverbalit të seancës gjyqësore datë 10.02.2025, në pëfundim	E plotë	Nuk ka

		informacionet e mëposhtme, të cilat nuk bien ndesh me kufizimet e parashikuara nga neni 17/a i këtij ligji. Do të vlerësonim nëse informacionin do të na i vendosni në një kohë sa më të shpejtë, për shkak të sensitivitetit që ka çështja. Përsa më sipër, kërkojmë nga ana juaj: 1.Dispozitivin në lidhje me gjykimin e shtetasve V.M, E.M, M.P dhe B.A. 2.Dhe emrat e personave të catuar për gjykim, trupën gjykuese dhe përfaqësuesin e akuzës të çështjes.Nga gazetari A.B		të gjykimit të çështjes penale ndaj të pandehurve V.M, E.M, B.A, M.P, akuzuar për veprën penale "Vrasja me paramendim", kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 78/1 e 25 i Kodit Penal, me viktimë nga vepra penale të ndjerin M. C, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët: znj. Luljeta Kole, znj. Eglantina Mikani, znj. Gentiana Shukullari pranoi kërkesën e prokurores znj. Ledjana Shkurti dhe vendosi: 1.Deklarimin fajtor të të pandehurit V.M për kryerjen e veprës penale “Vrasja me paramendim” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 78/1 e 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 25 (njëzet e pesë) vjet burgim. - Vuajtja e dënimit i fillon nga dita e ndalimit datë 17.06.2022, dhe dënimi do të kryhet në një burg të sigurisë së	
--	--	--	--	--	--

				zakonshme. 2.Deklarimin fajtor të të pandehurit E.M për kryerjen e veprës penale “Vrasja me paramendim” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 78/1 e 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 23 (njëzet e tre) vjet burgim. - Vuajtja e dënimit i fillon nga dita e ndalimit datë 17.06.2022, dhe dënimi do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme. 3.Deklarimin fajtor të të pandehurit B.A për kryerjen e veprës penale “Vrasja me paramendim” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 78/1 e 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 15 (pesëmbëdhjetë) vjet burgim. - Vuajtja e dënimit i fillon nga dita e ndalimit datë 17.06.2022, dhe dënimi do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme. 4.Deklarimin fajtore të të pandehurës M.P për kryerjen e		
--	--	--	--	---	--	--

				veprës penale “Vrasja me paramendim” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 78/1 e 25 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 20 (njëzet) vjet burgim. - Vuajtja e dënimit i fillon nga dita e ekzekutimit të masës së sigurimit “arrest në burg” të caktuar nga gjykata ndaj kësaj të pandehure, datë 14.10.2022, dhe dënimi do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme. 5. Provat materiale: aparatet e telefonave celularë, automjeti dhe dokumentacioni i tij, t’iu kthehen personave që iu përkasin; veshjet e viktimës, t’iu kthehen familjarëve të tij; disa fragmente ngjitësi natriban, të asgjësohen. 6. Shpenzimet proceduriale në fazën e hetimeve në masën 321.000 (treqind e njëzet e njëmijë) lekë iu ngarkohen të pandehurve në mënyrë solidare.		
--	--	--	--	---	--	--

				7. Kundër vendimit prokurori dhe të pandehurit mund të bëjnë ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.		
5.	13.02.2025	Kërkesë për informacion lidhur me masat e sigurisë dhënë në vitin 2024. Kërkoj nga ju të më vendosni në dispozicion statistikën e vitit 2024 lidhur me masat e sigurisë të dhëna nga kjo gjykatë. Nga gazetari Xh.Sh	14.02.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion dërguar në rrugë elektronike ku kërkon të dhëna mbi statistikën e vitit 2024 lidhur me masat e sigurisë ju informojmë se: Nga verifikimi i sistemit rezultojnë 437 masa sigurimi të dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për vitin 2024.	E plotë	Nuk ka
6.	17.02.2025	Kërkesë për informacion nëse në Gjykatën Korçë është depozituar ndonjë kërkesë, ose ndonje padi ose eventualisht ndonjë ankim ose çfaredo akti procedural tjetër, me palë (në cilindo pozicion procedural) trashëgimtarët e M. L	20.02.2025	Në përgjigje të e-mailit tuaj, ju informojmë se: Nga verifikimi i Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), nuk rezulton çështje ndaj shtetasve M. L, I.L, F.L gjithashtu ju bëjme me dije se çështjet në sistem verifikohen me	E plotë	Nuk ka

		ose në emër me pale: I. L ose F. L, ose I.Ç ose Z. E ose me pale tjetër me mbiemër S. Ju lutem te na informoni ne lidhje me çështje te regjistruara, qoftë më parë në kohe, qoftë aktualisht, ose çështje në ndjekje, me çfarëdo objekti, në veçanti të lidhura me pasuritë e paluajtshme. Gjithashtu, duke qënë se Gjykata Korçë ka një vendimarrje me objekt veçim pjesë takuese nga i cili rezulton se klientët që ne perfaqesojmë janë pjesë e atij vendimi dhe konkretisht në cilesinë e personave të tretë, dhe si të tilla tërheqin të drejta dhe detyrime, kërkojmë nga ana juaj të na vendosni ne dispozicion edhe nje kopje te ketij vendimi. Nga Av. E.D		emër-mbiemër të plotë. Ndaj shtetasve I.C dhe Z. E rezulton vetëm një çështje civile me objekt: “Pjestim dhe veçim pjesë takuese të debitorit bashkëpronar” ku gjykata ka dhënë vendim në datën 20.11.2020. Për tërheqjen e vendimit duhet të paraqiteni në krysekretari duke paguar dhe tarifën e vendimit.		
7.	28.02.2025	Kërkesë për informacion Sa kërkesa për urdhëra mbrojtje, urdhëra të menjëhershëm mbrojtje, ka marrë gjithsej	12.03.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion në lidhje me sa kërkesa për urdhëra mbrojtje, dhe urdhëra të menjëhershëm	E plotë	Nuk ka

		institucioni në 5 (pesë) vitet e fundit? Për sa prej tyre është bërë pranim i kërkesës, pushimi i gjykit, rrëzimi i kërkesës, shkelje e urdhërit të mbrojtjes? -Sa prej rasteve kanë pasur denoncuese gratë dhe vajzat? Nga gazetaria E.A		mbrojtje, të marra nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë në 5 (pesë) vitet e fundit, ju informojmë si më poshtë: • Për vitin 2020 janë dhënë: - 177 urdhëra të menjëhershëm mbrojtje. - 52 kërkesa pranuar - 116 kërkesa pushuar - 9 kërkesa rrëzuar - 143 raste kanë qënë denoncuese gjinia femër • Për vitin 2021 janë dhënë: - 153 urdhëra të menjëhershëm mbrojtje. - 49 kërkesa pranuar - 94 kërkesa pushuar - 10 kërkesa rrëzuar - 120 raste kanë qënë denoncuese gjinia femër		
--	--	--	--	--	--	--

				• Për vitin 2022 janë dhënë: - 137 urdhëra të menjëhershëm mbrojte. - 48 kërkesa pranuar - 81 kërkesa pushuar - 8 kërkesa rrëzuar - 110 raste kanë qënë denoncuese gjinia femër • Për vitin 2023 janë dhënë: - 218 urdhëra të menjëhershëm mbrojte. - 105 kërkesa pranuar - 92 kërkesa pushuar - 21 kërkesa rrëzuar - 169 raste kanë qënë denoncuese gjinia femër • Për vitin 2024 janë dhënë: - 232 urdhëra të menjëhershëm mbrojte. - 144 kërkesa pranuar		
--	--	--	--	--	--	--

				- 53 kërkesa pushuar - 35 kërkesa rrëzuar - 165 raste kanë qënë denoncuese gjinia femër.		
8.	03.03.2025	Kërkesë për informacion vënie në dispozicion të dy vendimeve civile nga z. R.T	13.03.2025	Vënë në dispozicion vendimet e anonimizuara	E plotë	Nuk ka
9.	20.03.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me paditë e marrëdhënieve të punës punëmarrës (individ) punëdhënës (shteti/pushtet qëndor/vendor), konkretisht sa çështje janë të fituara apo të humbura përballë shtetit duke marrë këtë statistikë për një periudhë 2 vjeçare (2023-2025) nga znj O.C	27.03.2025	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë pasi u njoh me shkresën me nr. 1659/1 prot, datë 18.03.2025, përcjellë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor mbi bazën e kërkesës tuaj, protokolluar pranë gjykatës me nr. 1247 prot, datë 20.03.2025, lidhur me informacionin në lidhje me paditë e marrëdhënieve të punës punëmarrës (individ) punëdhënës (shteti/pushtet qëndor/vendor), konkretisht sa çështje janë të fituara apo të humbura përballë shtetit duke marrë këtë statistikë për një periudhë 2 vjeçare (2023-2025), ju informojmë si më poshtë:	E plotë	Nuk ka

				Nga verifikimet e kryera në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë rezultojnë se çështjet me objekt padi për marrëdhënie pune punëmarrës (individ) punëdhënës (shteti/pushtet qëndor/vendor), Për vitin 2023, kanë përfunduar 9 çështje gjyqësore, ku 7 çështje janë pranuar, 1 çështje është pushuar dhe 1 çështje moskompetencë. Për vitin 2024 kanë përfunduar 10 çështje gjyqësore, ku 5 çështje janë pranuar, 1 çështje është rrëzuar, 3 çështje janë pushuar dhe 1 çështje moskompetencë.		
10.	15.04.2025	Kërkesë për informacion për listën me emrat dhe dokumentacion ligjor profesional të eksperteve autoteknik që caktohen për kryerjen e "akteve të ekspertimit autoteknike". Në zbatim të nenit 179	25.04.2025	Në vijim të e-mailit Tuaj, ju bëj me dije se: Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë nuk administrohen më listat e ekspertëve pasi në referim të Udhëzimit nr.	E plotë	Nuk ka

		të K.Pr.Penal, të nenit 227 K.Pr.Civile si dhe të nenit 38 të ligjit nr.9877 datë 18.02.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërise” kërkojmë nga ana juaj që listat e ekspertëve me njohuri të posaçme në fushat e shkencës për kryerjen e ekspertizave autoteknike që vijnë pranë prokurorive dhe gjykatave nga shoqata apo individe të ndryshëm të kalojnë në një filtër duke kontrolluar diplomat për degën që janë diplomuar dhe të dilet me vendim nga ana juaj. Kjo mendojmë se ndalohen abuzimet që janë berë deri tani. Në zbatim të 23 të Kushtetutës, nenit 10 e vijues të ligjit. Nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit” kërkojmë nga ana juaj të na vini në dispozicion listë e emrave të		10619, datë 19.10.2018 të Ministrit të Drejtësisë “Për krijimin, admnistrimin dhe vënien në dispozicion për publikun të regjistrit elektronik për ekspertët” është krijuar regjistri elektronik i ekspertëve. Caktimi i ekspertëve në proceset gjyqësore rregullohet sipas parashikimeve të nenit 224/a të Kodit të Procedurës Civile, të ndryshuar, në të cilën përcaktohet se ekspertët zgjidhen nga regjistri elektronik i personave të liçensuar , i cili administrohet dhe publikohet nga Ministria e Drejtësisë.		
--	--	--	--	---	--	--

		ekspertëve me njohuri të posaçme në fushat e shkencës për kryerjen e ekspertizave autoteknike. Nga Av. G.H				
11.	15.04.2025	Kërkesë për informacion kopje të vendimit të gjykatës për shtetasin E. L dhe Procesverbal të deklarimit për A.T gjatë gjykimit të shtetasit E.L nga gazetaria L.K	23.04.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, bashkëngjitur po iu vendosim në dispozicion vendimin e anonimizuar dhënë për shtetasin E.L. Në lidhje me procesverbalin e deklarimit për A.T gjatë gjykimit të shtetasit E.L iu informojmë se, deklaratimet janë të pasqyruara në vendimin gjyqësor.	E plotë	Nuk ka
12.	03.05.2025	Kërkesë për informacion ku kërkohet: 1-Statistikë - Numri total i masave të sigurimit personal të vendosura nga gjykata në vitin 2024 dhe 2025 2-Numri i masave të sigurimit personal “arrest me burg”. 3-Numri i masave të sigurimit personal për	14.05.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion iu informojmë si më poshtë: 1-Nga verifikimet e kryera në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për vitin 2024, rezultojnë 475 masa sigurimi të caktuara, nga të cilat: a-Arrest në burg – 215	E plotë	Nuk ka

		masa alternative: a. Detyrim paraqitjeje b.Garanci pasurore c.Arrest shtëpie d.Ndalim i daljes jashtë vendit e.Ndalim i kontaktit me persona të caktuar, etj. 4-Numri i personave të cilëve u është caktuar “arrest me burg” dhe që më pas janë shpallur të pafajshëm në vendimin përfundimtar. 5-Kohëzgjatja mesatare e paraburgimit për këta persona. 6-Nëse është e mundur, të dhëna mbi kërkesat për dëmshpërblim për paraburgim të padrejtë. Nga gazetari A.B		masa b-Arrest në shtëpi – 59 masa c-Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore – 189 masa d-Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik – 8 masa e-Moscaktim mase sigurimi – 3 masa f-Garanci pasurore – 1 masë 2-Për vitin 2025, 3 mujori i parë (janar-mars) rezultojnë 126 masa sigurimi të caktuara, nga të cilat: a-Arrest në burg – 36 masa b-Arrest në shtëpi – 12 masa c-Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore – 75 masa d-Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik – 2 masa e-Garanci pasurore – 1 masë 3-Përsa i takon pikes 4 dhe 5 ku kërkoni numrin e personave të cilëve u	
--	--	--	--	---	--

				është caktuar “arrest me burg” dhe që më pas janë shpallur të pafajshëm në vendimin përfundimtar dhe kohëzgjatjen mesatare të paraburgimit për këta persona ju informojmë se, gjykata nuk mban evidenca statistikore të tilla. 4- Përsa i takon pikes 6, të dhëna mbi kërkesat për dëmshpërblim për paraburgim të padrejtë nuk rezulton asnjë çështje e regjistruar me këtë objekt.		
13.	19.05.2025	Kërkesë për informacion ekipi kërkimor me seli në Universitetin Charles në Prauge, i cili studion kornizat e dënimeve në të gjithë Evropën. Do të dëshironim t'ju kërkoni të na jepnit një mostër të vendimeve penale të zgjedhura rastësisht të dhëna nga gjykata juaj pas 1 tetorit 2024. Në mënyrë specifike, do të dëshironim të merrnim vendime me tekst të	27.05.2025	Duke shprehur konsideratën tonë për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të kërkesës tuaj të dërguar nëpërmjet postës elektronike të Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë më datë 19.05.2025, ju bëjmë me dije se, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”, kërkesa për dhënie informacioni është	E plotë	Nuk ka

		plotë në rastet e vjedhjes në variantet e mëposhtme: - Pesë (5) vendime në rastet e vjedhjes dhe - Pesë (5) urdhra penalë në rastet e vjedhjes. Qëllimi ynë është të krahasojmë se si duken vendimet e gjykatave në të gjithë Evropën dhe nëse vendimet penale përmbajnë deklarata faktesh. Nga shtetësia D.S		shqyrtuar, dhe bashkengjitur po ju vendosim në dispozicion pesë (5) vendimet penale të anonimizuara të zgjedhura rastësisht me objekt “vjedhja”, për periudhën pas 1 Tetorit 2024. Përsa i takon pesë (5) vendimeve me objekt “kërkesë për miratimin e urdhërit penal” në rastet e vjedhjes, ju informojmë se, për periudhën pas 1 Tetorit 2024 nuk rezulton asnjë vendim i dhënë me këte objekt.		
14.	30.05.2025	Kërkesë për informacion ku kërkohet: 1-Statistikë - Numri total i masave të sigurimit personal të vendosura nga gjykata në vitin 2024 dhe 2025 2-Numri i masave të sigurimit personal “arrest me burg”. 3-Llojet e veprave penale për të cilat është kërkuar “arrest me burg. 4-Numri i masave të sigurimit personal për	04.06.2025	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë pasi u njoh me shkresën me nr. 2728/1 prot, datë 29.05.2025, përcjellë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor mbi bazën e kërkesës tuaj, protokolluar pranë gjykatës me nr. 2412 prot, datë 30.05.2025, ju informon si më poshtë: 1-Nga verifikimet e kryera në Gjykatën e Shkallës së Parë të	E plotë	Nuk ka

		masa alternative: a. Detyrim paraqitjeje b.Garanci pasurore c.Arrest shtëpie d.Ndalim i daljes jashtë vendit e.Ndalim i kontaktit me persona të caktuar, etj. 5-Numri i personave të cilëve u është caktuar “arrest me burg” dhe që më pas janë shpallur të pafajshëm në vendimin përfundimtar. 6-Kohëzgjatja mesatare e paraburgimit për këta persona. 6-Nëse është e mundur, të dhëna mbi kërkesat për dëmshpërblim për paraburgim të padrejtë. Nga gazetari A.B		Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për vitin 2024, rezultojnë 475 masa sigurimi të caktuara, nga të cilat: a-Arrest në burg – 215 masa b-Arrest në shtëpi – 59 masa c-Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore – 189 masa d-Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik – 8 masa e-Moscaktim mase sigurimi – 3 masa f-Garanci pasurore – 1 masë 2-Për vitin 2025, (janar-maj) rezultojnë180 masa sigurimi të caktuara, nga të cilat: a-Arrest në burg – 57 masa b-Arrest në shtëpi – 19 masa c-Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore – 100 masa d-Shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik – 3 masa	
--	--	--	--	--	--

				e-Garanci pasurore – 1 masë 3-Llojet e veprave penale për të cilat është kërkuar “arrest në burg” janë, “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” “Dhuna në familje” “Plagosja e rënde me dashje” “Prodhim dhe shitje narkotikësh” “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës” “Largimi i të burgosurit nga vendi i qëndrimit” “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” “Kanosja” “Ngacmimi seksual” 4-Përsa i takon pikes 5 dhe 6 ku kërkon numrin e personave të cilëve u është caktuar “arrest me burg” dhe që më pas janë shpallur të pafajshëm në vendimin përfundimtar dhe kohëzgjatjen mesatare të paraburgimit për këta persona ju informojmë se, gjykata nuk mban evidenca statistikore të tilla.		
--	--	--	--	---	--	--

				5-Përsa i takon pikes 7, të dhëna mbi kërkesat për dëmshpërblim për paraburgim të padrejtë nuk rezulton asnjë çështje e regjistruar me këtë objekt.		
15.	11.06.2025	Kërkesë për informacion 1-Sa është numri i çështjeve nën gjykim për të moshuarit që ju kanë jumbur vitet e punës dhe që kanë hapur padi për pensionet? 2- Sa vendime u dhanë për 2024 për padi pensioni? 3- Sa është numri i padive të divorceve në gjykim? 4- Sa çështje martesash janë zgjidhur gjatë 2024? 5- Statistika në lidhje me paditë për kompensim burgimi të padrejtë, sa janë aktualisht dhe sa kanë qëne vitin e kaluar? Nga gazetaria A.H	16.06.2025	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë pasi u njoh me shkresën me nr. 2957/2 prot datë 09.06.2025, përcjellë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor mbi bazën e kërkesës tuaj, protokolluar pranë gjykatës me nr. 2599 prot, datë 11.06.2025, ju informojmë se nga verifikimi i Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) si dhe nga statistikat vjetore të gjykatës rezulton si më poshtë: 1.Sa është numri i çështjeve nën gjykim për të moshuarit që ju kanë jumbur vitet e punës dhe që kanë hapur padi për pensionet? Në gjykim janë 47 çështje me objekt	E plotë	Nuk ka

				vërtetim fakti juridik vjetërsie në punë. 2.Sa vendime u dhanë për 2024 për padi pensioni? Për vitin 2024: janë përfunduar me vendim 48 çështje me objekt “vërtetim fakti juridik vjetërsie në punë. 3.Sa është numri i padive të divorceve në gjykim? Në gjykim janë 254 çështje me objekt zgjidhje martese. 4.Sa çështje martesash janë zgjidhur gjatë 2024? Për vitin 2024: janë përfunduar me vendim 484 çështje me objekt zgjidhje martese 5.Statistika në lidhje me paditë për kompensim burgimi të padrejtë, sa janë aktualisht dhe sa kanë qënë vitin e kaluar? Nuk rezulton asnjë çështje e regjistruar me këtë objekt për vitin 2024-2025.		
16.	12.06.2025	Kërkesë për informacion për plotësimin e pyetësorit	16.06.2025	Duke shprehur konsideratën tonë për veprimtarinë tuaj, në	E plotë	Nuk ka

		të Zyrës së OKB-së për Drogat dhe Krimin (UNODC) lidhur me trafikimin e qënieve njerëzore për vitin 2024.		përgjigje të kërkesës tuaj të dërguar nëpërmjet postës elektronike më datë 12.06.2025, me objekt “ Kërkesë për informacion në kuadër të plotësimit të pyetësorit të Zyrës së OKB-së për Drogat dhe Krimin (UNODC) lidhur me trafikimin e qënieve njerëzore”, ju bëjmë me dije se: Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për vitin 2024 nga verifikimet e kryera, nuk rezultojnë të dhëna për regjistrim çështjesh gjyqësore që lidhen me veprën penale “Trafikimi i qënieve njerëzore”, Neni: 110/a; 110/b; 110/c; 114; 128/b.		
17.	02.07.2025	Kërkesë për informacion mbi statistikën për paditë e shpërblimit të demit në rang vendi, specifikuar sipas objektit: nga aksidentet automobilistike,	09.07.2025	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë pasi u njoh me shkresën me nr. 3619/2 prot datë 01.07.2025, përcjellë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor mbi bazën e kërkesës	E plotë	Nuk ka

		marrëdhëniet e punës dhe nga shkelja e rregullave të mbrojtjes në punë. Nga gazetaria A.H		tuaj, protokolluar pranë gjykatës me nr. 3022 prot, datë 02.07.2025, iu informojmë se nga statistikat për periudhën Janar - Qershor të vitit 2025 për paditë shkaktim dëmi rezultojnë si më poshtë: Mbartur nga viti 2024 – 74 çështje Ardhur të reja për vitin 2025 – 10 çështje Përfunduar për vitin 2025 – 6 çështje 3 çështje janë pranuar 2 çështje janë refuzuar 1 çështje është pushuar		
18.	14.07.2025	Kërkesë për informacion për kryerjen e një studimi në fushën e mjedisit dhe kam nevojë për ndihmën tuaj. Me nevojiten vendimet nga viti 2019 deri ne 2025 për këto vepra ne focus të studimit Neni 201- NDOTJA E AJRIT NENI 202 – Transportimi i mbetjeve toksike	16.07.2025	Në përgjigje të e-mailit tuaj iu informojmë se: Nga verifikimet e kryera për vitet 2019-2025 në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, rezultojnë 16 vendime me objekt “Prerja e paligjshme e pyjeve” parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal. Përsa i takon veprave të tjera nuk rezulton asnjë vendim i dhënë.	E plotë	Nuk ka

		Neni 203- ndotja e ujrave Neni 204- peshkim i ndaluar Neni 205- prerje e paligjshme e pyjeve Neni 206- prerje e drurëve dekorative dhe frutore Neni 206/a- shkatërrim me zjarr i pyjeve dhe mjedisit pyjor Neni 206/b- shkatërrimi nga pakujdesia me zjarr i pyjeve dhe mjedisit pyjor Neni 207- shkelja e karantinës së bimëve dhe kafshëve. Nga gazetaria A.H		Bashkëngjitur po iu dërgojmë vendimet e anonimizuara.		
19.	01.09.2025	Kërkesë për informacion për vënie në dispozicion të vendimeve penale dhe civile për periudhën 2022-2025 ndaj shtetasit Dh.K nga gazetari S.K	02.09.2025	Nga verifikimi i Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), rezultojnë vetëm tre vendime për periudhën 2022-2025 ndaj shtetasit Dh.K. Bashkëngjitur po iu vendos në dispozicion vendimet e anonimizuara.	E plotë	Nuk ka

20.	01.09.2025	Kërkesë për informacion Sa vendime janë disponuar gjatë dhjetë viteve të fundit nga gjykatat e shkallëve të para, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë për gjkime administrative të kërkesëpadive me shkak ligjor ligjin nr. 10431.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe/ose Konventa e Aarhusit? Çfarë kanë vendosur gjykatat për gjykimet administrative të kërkesëpadive me shkak ligjor ligjin nr. 10431.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe/ose Konventa e Aarhusit? Sa vendime janë disponuar gjatë dhjetë viteve të fundit nga gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë për përshpejtimin e gjykimit për gjkime administrative të kërkesëpadive me shkak ligjor ligjin nr.	10.09.2025	Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë pasi u njoh me shkresën me nr. 4581/1 prot, datë 26.08.2025, përcjellë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor mbi bazën e kërkesës tuaj, protokolluar pranë gjykatës me nr. 3857 prot, datë 29.08.2025, iu informojmë se nga verifikimi i Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), rezultojnë të dhënat si më poshtë: Viti 2016: Janë përfunduar me vendim 16 çështje me objekt “Prerja e paligjshme e pyjeve”, parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal. Në të 16 çështjet gjykata ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurve”. Kohëzgjatja e gjykimit në 13 çështje ka qënë 0-3 muaj dhe në 3 çështje 3-6 muaj. Viti 2017: Janë përfunduar me	E plotë	Nuk ka
-----	------------	--	------------	--	---------	--------

		10431.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe/ose Konventa e Aarhusit? Sa vendime pranimi dhe refuzimi janë disponuar nga gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë për kërkesat për përsheptimin e gjykimit në gjykimet administrative të kërkesëpadive me shkak ligjor ligjin nr. 10431.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe/ose Konventa e Aarhusit? Cila është kohëzgjatja e gjykimeve të regjistruara gjatë dhjetë viteve të fundit nga gjykatat e shkallëve të para, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë për gjykime administrative të kërkesëpadive me shkak ligjor ligjin nr. 10431.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe/ose Konventa e Aarhusit (në secilën nga shkallët e gjykimit)?		vendim 2 çështje me objekt “Prerja e paligjshme e pyjeve”, parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal. Në të 2 çështjet gjykata ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurve”. Kohëzgjatja e gjykimit në 2 çështjet ka qënë 0-3 muaj. Viti 2018: Janë përfunduar me vendim 4 çështje me objekt “Prerja e paligjshme e pyjeve”, parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal. Në 3 çështje gjykata ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurve” dhe në 1 çështje ka vendosur “pafajësi”. Kohëzgjatja e gjykimit në të 4 çështjet ka qënë 0-3 muaj. Viti 2019: Janë përfunduar me vendim 12 çështje me objekt “Prerja e paligjshme e pyjeve”, parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal.		
--	--	---	--	---	--	--

		Sa vendime janë disponuar gjatë dhjetë viteve të fundit nga gjykatat e shkallëve të para, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë për procedime penale lidhur me veprat penale kundër mjedisit (nenet 201 deri 207/ç të Kodit Penal)? Çfarë kanë vendosur gjykatat për procedimet penale lidhur me veprat penale kundër mjedisit (nenet 201 deri 207/ç të Kodit Penal)? Cila është kohëzgjatja e gjykimeve të regjistruara gjatë dhjetë viteve të fundit nga gjykatat e shkallëve të para, gjykatat e apelit dhe Gjykata e Lartë për procedime penale lidhur me veprat penale kundër mjedisit (nenet 201 deri 207/ç të Kodit Penal" (në secilën nga shkallët e gjykimit)? Informacioni i mësipërm të paraqitet i individualizuar për çdo vit. Nga z. F.T		Në 10 çështje gjykata ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurve”, në 1 çështje ka vendosur “pafajësi”, dhe në 1 çështje “Pushimin e çështjes”. Kohëzgjatja e gjykimit në 10 çështje ka qënë 0-3 muaj dhe në 2 çështje 3-6 muaj. Viti 2020: Janë përfunduar me vendim 2 çështje me objekt “Prerja e paligjshme e pyjeve”, parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal. Në të 2 çështjet gjykata ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurve”. Kohëzgjatja e gjykimit në të 2 çështjet ka qënë 0-3 muaj. Viti 2021: a.) Janë përfunduar me vendim 11 çështje me objekt “Prerja e paligjshme e pyjeve”, parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal. Në të 11 çështjet gjykata ka vendosur “Deklarimin	
--	--	--	--	--	--

				fajtor të të pandehurve”. Kohëzgjatja e gjykimit në 7 çështje ka qënë 0-3 muaj dhe në 4 çështje 3-6 muaj. b.) Janë përfunduar me vendim 2 çështje me objekt “Peshkimi i ndaluar”, parashikuar nga neni 204 i Kodit Penal. Në të 2 çështjet gjykata ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurve”. Kohëzgjatja e gjykimit në 1 çështje ka qënë 0-3 muaj dhe në 1 çështje 3-6 muaj. c.) Është përfunduar me vendim 1 çështje me objekt “Braktisja e kafshës së shoqërimit”, parashikuar nga neni 207/a i Kodit Penal. Në këtë çështje gjykata ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurit”. Kohëzgjatja e gjykimit ka qënë 0-3 muaj. d.) Është përfunduar me vendim 1 çështje me objekt “Vrasja me dashje e kafshës së shoqërimit”, parashikuar nga neni		
--	--	--	--	---	--	--

				207/b i Kodit Penal. Në këtë çështje gjykata ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurit” Kohëzgjatja e gjykimit ka qënë 3-6 muaj. Viti 2022: Janë përfunduar me vendim 5 çështje me objekt “Prerja e paligjshme e pyjeve”, parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal. Në 3 çështje gjykata ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurve” dhe në 2 çështje ka vendosur “pafajësi”. Kohëzgjatja e gjykimit në 1 çështje ka qënë 0-3 muaj, në 1 çështje 3-6 muaj, në 1 çështje 6 muaj-1 vit në 1 çështje 1-2 vjet, dhe 1 çështje mbi 2 vjet. Viti 2023: Janë përfunduar me vendim 4 çështje me objekt “Prerja e paligjshme e pyjeve”, parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal. Në të 4 çështjet gjykata		
--	--	--	--	--	--	--

				ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurve”. Kohëzgjatja e gjykimit në të 4 çështje ka qënë 0-3 muaj. Viti 2024: a.) Është përfunduar me vendim 1 çështje me objekt “Prerja e paligjshme e pyjeve”, parashikuar nga neni 205 i Kodit Penal. Në këtë çështje gjykata ka vendosur “pafajësi”. Kohëzgjatja e gjykimit ka qënë 1-2 vjet. b.) Është përfunduar me vendim 1 çështje me objekt “Vrasja me dashje e kafshës së shoqërimit”, parashikuar nga neni 207/b i Kodit Penal. Në këtë çështje gjykata ka vendosur “pushimin e çështjes”. Kohëzgjatja e gjykimit ka qënë 1-2 vjet. Viti 2025: Nuk rezulton asnjë çështje parashikur nga nenet 201 deri 207/ç të Kodit Penal.		
--	--	--	--	---	--	--

				Gjithashtu iu informojmë se përsa i takon veprave të tjera parashikur nga nenet 201, 201/a, 201/b, 201/c, 201/ç, 202, 202/a, 202/b, 203, 206, 206/a, 206/b, 207, 207/c, 207/ç, nuk rezulton asnjë vendim i dhënë.		
21.	24.09.2025	Kërkesë për informacion për vënie në dispozicion të vendimit për caktimin e masës së sigurimit personal, në ngarkim të shtetasit I.S, për veprën penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”. Nga gazetari A.B	01.10.2025	Në vijim të kërkesës suaj për informacion, dërguar në rrugë elektronike më datë 22.09.2025, ku keni kërkuar vendimin për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit I.S, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare” parashikuar nga neni 79/c i Kodit Penal, iu informojmë si më poshtë: Kjo çështje ndodhet në fazën e hetimit paraprak dhe vendimi i caktimit të masës së sigurimit përmban të dhëna që lidhen me veprimet e para hetimore. Sjellim në vëmendje që seanca gjyqësore ku është marrë	E refuzuar	Nuk ka

				vendimi i caktimit të masës së sigurimit për personin nën hetim I.S është zhvilluar me dyer të mbyllura. Në këtë këndvështrim gjykata, bazuar në nenin 279 të Kodit të Procedurës Penale, ka detyrimin ligjor të ruajë sekretin hetimor në kuadër të hetimeve të ndërmarra nga organi procedues. Në referim të nenit 17, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, e drejta për informim mund të kufizohet kur është e domosdoshme dhe proporcionale, në rastet kur dhënia e informacionit do të shkaktonte një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave si: “parandalimi, hetimi dhe ndjekja e veprave penale”.Mbajtur parasysh interesin e lartë publik lidhur me çështjen për të cilën po hetohet shtetasi I.S, gjykata ka publikuar		
--	--	--	--	--	--	--

				në faqen zyrtare të saj dispozitivin e vendimit të caktimit të masës së sigurimit ndaj tij, një kopje e të cilit iu është vënë në dispozicion edhe përfaqësuesve të mediave të ndryshme. Përsa më siper, vlerësohet se nuk mund t'iu vihet në dispozicion kopja e plotë e vendimit të caktimit të masës së sigurimit për personin nën hetim I.S.		
22.	25.09.2025	Rrjeti për Raportimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Shqipëri, po punon për realizimin e një artikulli mbi ndërtimet pa leje në Shqipëri. Më qëllim realizimin e detyrës por dhe në bazë të ligjit nr. 190 dt. 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, neni 3, kërkojmë të informohemi dhe të na vihen në dispozicion dokumente për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm” i parashikuar në nenin	01.10.2025	Duke shprehur konsideratën tonë për veprimtarinë tuaj, në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, dërguar nëpërmjet postës elektronike, iu bëjmë me dije se, Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për periudhën 2015-2025 rezutojnë një numër i madh vendimesh për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a të Kodit të Procedurës Penale. Ky informacion gjendet në	E plotë	Nuk ka

		199/a të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Më konkretisht jemi të interesuar të kemi të dhënat e mëposhtme për periudhën kohore 2015-2025, në qarkun e Korçës: 1- Të na vini në dispozicion kopje të vendimeve ndaj personave të akuzuar për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”. Nga znj. E.M		portaltin e gjykatave www.gjykata.gov.al duke aksesuar linkun: https://gjykata.gov.al/rrethi-korc%C3%AB/gjykata-eshtjet-gjyq%C3%ABshtjet-penale/c%C3%ABshtjet-penale/ dhe në rubriken “Lloji i çështjes” zgjidhni objektet “Kryerje punime pa leje ndertimi” si dhe “Ndërtim i paligjshëm” dhe duke klikuar në opsionin Kërko do të bëhet e mundur shfaqja e te gjitha çështjeve me vendimet e anonimizuara me këtë objekt kërkimi si dhe duke i shkarkuar ato.		
23.	10.10.2025	Kërkesë për informacion staf i Shteg.org po punon mbi një artikull për veprën penale "Ndërtim i paligjshëm". Do të doja që nga ana	16.10.2025	Në vijim të kërkesës suaj datë 10.10.2025 për vënien në dispozicion të kopjeve të kërkesave për gjykim të depozituara pranë Gjykatës së	E plotë	Nuk ka

		juaj të më ofrohet një kopje e kërkesave për gjykim i veprave penale referuar neni 199/a (i lartpermendur), qe numerohen në qarkun e Korçës për periudhën 2015-2025 Nga znj. E.M		Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë që lidhen me veprën penale “Ndërtim i paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, për periudhën 2015–2025, iu informojmë se: Pas verifikimeve të kryera rezulton i pamundur identifikimi i këtij informacioni për shkak të volumit shumë të madh të dosjeve që do të duhej të kontrolloheshin për nxjerrjen e kërkesave të kërkuara. Kërkesat nuk mund të evidentohen në mënyrë të automatizuar por nevojitet verifikim manual i çdo dosje në arkivën e gjykatës, çka e bën objektivist të pamundur nxjerrjen e vënien e tyre në dispozicionin tuaj. Megjithatë iu informojmë se, kërkesat për gjykim të përcjella nga prokuroria janë të pasqyruara sipas përmbajtjes së tyre në		
--	--	---	--	--	--	--

				vendimet gjyqësore, për të cilat, në komunikimin e mëparshëm, iu është treguar adresa përkatëse në portalin e gjykatës se ku mund t'i aksesoni.		
24.	18.11.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me gjykimin në ngarkim të personave të përfshirë për vrasjen e shtetasit E.P. Kopje të vendimit për ndryshimin e masës së sigurisë për shtetasit L.G dhe D.M. Nga gazetari A.B.	18.11.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj, iu informojmë se: Me vendimet përkatëse të datave 15.11.2025 e 16.11.2025 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, mbi bazën e kërkesës së personave nën hetim D.M, L.G, (të cilët janë duke u hetuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për veprën “Vrasja me dashje” e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 76 e 25 i Kodit Penal) dhe personit nën hetim V.Sh (i cili është duke u hetuar për veprat penale “Moskallzimi i krimit” parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe “Veprime që	E plotë	Nuk ka

				pengojnë zbulimin e së vërtetës” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 301 e 25 i Kodit Penal), gjykata ka konstatuar se afatet e paraburgimit lidhur me masat e sigurimit personal caktuar për ta (D.M “Arrest në burg”, L.G “Arrest në burg”, V.Sh “Arrest në shtëpi”), edhe pas zgjatjes së tyre sipas periudhës që parashikohet nga ligji procedural penal (neni 264) kanë përfunduar. Në vijim, mbi bazën edhe të kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë gjykata, pasi ka konstatuar kumbjen e fuqisë së paraburgimit për shkak të kalimit të afateve ligjore të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale, ka caktuar për ta masa të tjera sigurimi (të		
--	--	--	--	--	--	--

				ndryshme nga ato për të cilat ka kaluar afati i paraburgimit). Konkretisht: për personim nën hetim D.M ka caktuar masën e sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, për personim nën hetim L.G ka caktuar masën e sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, dhe për personim nën hetim V.Sh ka caktuar masën e sigurimit personal “Detyrim për tu paraqitur në Policinë Gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”. Lidhur me venien në dispozicion të kopjeve të vendimeve përkatëse, ashtu siç iu është bërë me dije edhe në komunikimet e mëparshme, nisur nga fakti që çështja ndodhet në fazën e hetimit paraprak, dhe seancat gjyqësore ku janë marrë këto vendime janë zhvilluar me dyer të mbyllura, ato nuk mund		
--	--	--	--	--	--	--

				t'iu vihen në dispozicion. Kjo, në këndvështrim të nenit 279 të Kodit të Procedurës Penale, ku gjykata ka detyrimin ligjor të ruajë sekretin hetimor në kuadër të hetimeve të ndërmarra nga organi procedues (vendimet përmbajnë të dhëna që lidhen me veprimet hetimore). Sjellim në vëmendje se, në referim të nenit 17, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, e drejta për informim mund të kufizohet kur është e domosdoshme dhe proporcionale, në rastet kur dhënia e informacionit do të shkaktonte një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave si: “parandalimi, hetimi dhe ndjekja e veprave penale”.		
25.	19.11.2025	Kërkesë për informacion çfarë masa sigurimi personal janë caktuar për personat e përfshirë	19.11.2025	Në përgjigje të kërkesës tuaj, iu informojmë se: Me vendimet përkatëse te datave 15.11.2025 e	E plotë	Nuk ka

		në vrasjen e shtetasit E.P dhe veprat penale për të cilat akuzohen shtetasit: D.M, L.G, V.Sh dhe A.M. Pse është ndryshuar masa e sigurimit personal ndaj tyre? Nga gazetare Dh.Ç		16.11.2025 Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, mbi bazën e kërkesës së personave nën hetim D.M, L.G, (të cilët janë duke u hetuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për veprën “Vrasja me dashje” e kryer në bashkëpunim parashikuar nga neni 76 e 25 i Kodit Penal) dhe personit nën hetim V.Sh (i cili është duke u hetuar për veprat penale “Moskallzimi i krimit” parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës” kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 301 e 25 i Kodit Penal) gjykata ka konstatuar se afatet e paraburgimit lidhur me masat e sigurimit personal caktuar për ta (D.M		
--	--	---	--	---	--	--

				“Arrest në burg”, L.G “Arrest në burg”, V.Sh “Arrest në shtëpi”), edhe pas zgjatjes së tyre sipas periudhës që parashikohet nga ligji procedural penal (neni 264) kanë përfunduar. Në vijim, mbi bazën edhe të kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë gjykata, pasi ka konstatuar kumbjen e fuqisë së paraburgimit për shkak të kalimit të afateve ligjore të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale, ka caktuar për ta masa të tjera sigurimi (të ndryshme nga ato për të cilat ka kaluar afati i paraburgimit). Konkretisht: për personim nën hetim D.M ka caktuar masën e sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, për personim nën hetim L.G ka caktuar masën e		
--	--	--	--	--	--	--

				sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, dhe për personim nën hetim V.Sh ka caktuar masën e sigurimit personal “Detyrim për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit“.		
26.	25.11.2025	Kërkesë për informacion sa urdhëra mbrojtjeje dhe sa urdhëra të menjëhershëm mbrojtjeje janë lëshuar nga Gjykata e Shkallës së Parë, Juridiksion i Përgjithshëm Korçë gjatë vitit 2024? Sa urdhëra mbrojtjeje dhe sa urdhëra të menjëhershëm mbrojtjeje janë lëshuar deri në datën e këtij kërkimi për vitin 2025? Nga gazetari Xh.Sh	26.11.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, bashkëngjitur ju vëmë në dispozicion të dhënat e kërkuara mbi statistikën vjetore për vitin 2024, si dhe për periudhën janar– shtator 2025, lidhur me urdhërat e mbrojtjes. Për vitin 2024 - gjithsej 232 Urdhëra të menjëhershëm mbrojtje Janar-shator 2025 - gjithsej 127 Urdhëra të menjëhershëm mbrojtje. Ju informojmë se përpunimi dhe nxjerrja e statistikave zyrtare të gjykatës kryhet në përfundim të çdo tremujori të vitit kalendarik.	E plotë	Nuk ka

27.	02.12.2025	Kërkesë për informacion nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. 1- A ka pasur praktika nga gjykatat lidhur me çështje të ngacmimit seksual dhe dhunës në vendin e punës, gjatë dhjetë viteve të fundit? 2- Nëse ka pasur praktika të tilla, kërkohet vendosja në dispozicion e kopjeve të vendimeve gjyqësore që kanë disponuar në lidhje me këto çështje.	12.12.2025	Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, nëpërmjet shërbimit postar është përcjellë shkresa e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 6205/1 Prot, datë 26.11.2025, në të cilët kërkohet informacion nëse ka patur praktikë nga gjykata lidhur me çështje të ngacmimit seksual dhe dhunës në vendin e punës, gjatë dhjetë viteve të fundit, ju bëjme me dije se: Nga verifikimi i sistemit ICMIS nuk rezulton të ketë patur çështje të ngacmimit seksual dhe dhunës në vendin e punës për dhjetë vjeçarin e fundit.	E plotë	Nuk ka
28.	02.12.2025	Kërkesë për informacion 1. Cili është vendimi për çështjen civile dhjetor 2023 vendim nr. 566 prot dt. 29.04.23 Gj.P? 2. A vazhdojnë të vinë vendime nga zyra përmbartimore “ E.B.O”	09.12.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, iu informojmë si më poshtë: Nisur nga të dhënat e	E plotë	Nuk ka

		për këtë çështje? 3. A është caktuar një përmbarues gjyqësor privatë zëvendësues për çështjen e Gj.P nga zyra përmbarimore “E.B.O”? Emisioni “ V ”		vëna në dispozicion nga ana juaj, nga verifikimi i Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) nuk rezulton vendim nr. 566 prot. datë 29.04.2023 për Gj.P, apo vendim për ndonjë çështje civile 2023 të tij. Lidhur me ardhje vendimesh nga Zyra Përmbarimore “ E.B.O ” përsa i përket vendimeve të sipërcituara, nuk mund të evidentohen të tilla përsa kohë ato nuk janë gjetur sipas përgjigjes së kthyer më lart. Gjykata sjell në vëmendje se, nga përmbaruesit gjyqësorë, paraqiten në gjykatë akte me qëllim publikimin e tyre në rastet e mosnjohftimeve të palëve në adresat zyrtare të tyre, dhe nuk dorëzohen vendime që ata marrin gjatë punës së tyre. Nëse do të kërkohet ndonjë i tillë, është e nevojshme paraqitja e të dhënave të sakta lidhur me titullin	
--	--	--	--	--	--

				ekzekutiv për të cilin është duke u zhvilluar procedura përmbaremore. Duke qënë se procedura përmbaremore për një titull ekzekutiv ndiqet nga një përmbareues gjyqësor sipas kërkesës së kreditorit, i cili në ushtrimin e detyrës së tij nuk ka ndonjë lidhje me gjykatën, kjo e fundit nuk mund të ketë informacion se cili është përmbareuesi që ndjek ekzekutimin e detyrueshëm të një titulli ekzekutiv apo nëse përmbareuesi fillestar është zëvendësuar nga ndonjë tjetër gjatë procedurës përmbaremore. Momenti se kur gjykata mund të vijë në dijeni se një përmbareues gjyqësor i caktuar është duke ndjekur procedurën e ekzekutimit të një titulli ekzekutiv është kur paraqitet ankimi lidhur me ndonjë veprim përmbaremor të tij. Në të kundërt, gjykata nuk		
--	--	--	--	---	--	--

				disponon informacionin që kërkoni. Në tërësi, nisur nga informacioni që kërkoni me e-mailin tuaj gjykata sqaron se, nëse prej jush nuk vihen në dispozicion të dhëna të sakta lidhur me vendime të dhëna apo çështje në gjykim, gjithmonë për sa i takon gjykatës, kjo e fundit është në pamundësi t'iu vejë në dispozicion informacionet përkatëse.		
29.	11.12.2025	Kërkesë për informacion lidhur me vendimin penal nga znj. E.F.	22.12.2025	Përcjellë informacioni.	E plotë	Nuk ka
30.	16.12.2025	Kërkesë për informacion 1. Nëse ka një vendim nga institucioni juaj, në lidhje me çështjen e titullit ekzekutiv të mbajtur ndaj individit Gj.P nga viti 2020-2025. 2. Nëse ka patur paraqitje të përmbauesit gjyqësor privat D.B apo P.P, nga zyra përmbaimore "E.B.O", për çështjen e titullit ekzekutiv ndaj individit Gj.P dhe A.P, nga viti	24.12.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, iu informojmë si më poshtë: Nga verifikimi i Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), rezultojnë dy vendime të dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për	E plotë	Nuk ka

		2020-2025. Nëse po, cilat kanë qenë kërkesat e tyre pranë institucionit tuaj? Kërkojmë të na vihen në dispozicion një kopje e këtyre kërkesave/ vendimeve, iu lutem. 3. A është kërkuar ndonjë titull tjetër ekzekutiv nga kjo zyrë gjyqësore përmbarimore private për të njëjtin individ Gj.P dhe A.P Nëse po, cilat janë ato? Kërkojmë të na vihen në dispozicion një kopje e këtyre vendimeve, iu lutem. 4. A ka ndonjë vendim tjetër të vendosur e të dokumentuar e të paraqitur pranë institucionit tuaj nga zyra gjyqësore përmbarimore private “E.B.O” nga viti 2020-2025, ndaj individëve Gj.P dhe A.P ? Nëse po, kërkojmë të na vihet në dispozicion një kopje e këtyre vendimeve, Emisioni “ V”		periudhën 2020-2025 me palë ndërgjyqëse Gj.P, Zyra përmbarimore private “E.B.O”. Përsa i takon informacioneve të tjera të kërkuara, nuk disponohen të dhëna. Bashkëngjitur po ju dërgojmë vendimet e anonimizuara.		
--	--	--	--	---	--	--